MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN XARRË, SARANDË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Xarrë, Sarandë, me objekt: **“**“Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit,lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë komunale, etj.”dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.54 , datë 26. 04.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 146/5, datë 06.02.2012, dërguar **z. Dhimitër Kote,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të organizohet puna në grup për hartimin e projektbuxhetit dhe PBA me specialist nga zyrat përgjegjëse të komunës duke harmonizuar veprimet për analizimin e nevojave dhe burimeve dhe të paraqiten në Këshillin e Komunës për miratim brenda muajit dhjetor të vitit si dhe të merren masa për monitorimin e zbatimit të buxhetit çdo tremujor.

Vazhdimisht

2. Nga ana e administratës së Komunës, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të hartohet dhe të miratohet në Këshillin e Komunës, Rregullorja e Brendshme e Komunës “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Komunës”.

Menjëherë

3. Të merren masa për krijimin e dosjeve të personelit me të dhënat e kërkuara, të evidentohet vjetërsia në librezat e punës dhe të fillojë vlerësimi i performancës periodike për administratën.

Menjëherë

4. Të merren masa për organizimin e një trajnimi për njohjen dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, manualin e ministrisë financave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me urdhrin nr. 8980, datë 15.07.2010, të cilat kanë hyrë në fuqi më 01.01.2011, si dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

5. Të merren masa për krijimin e hapësirës së nevojshme për magazinimin e mallrave dhe ruajtjen e tyre, të hapen kartelat përkatëse analitike me qëllim që të shmanget informaliteti i veprimeve me magazinën dhe të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit.

Menjëherë

6. Të merren masa të menjëhershme nga komuna, për krijimin e zyrës së aseteve e cila te kryej inventarizimin, vlerësimin, marrjen në dorëzim të pronave dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 500,

datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” sipas pikave 9,10,11,13,14.

Menjëherë

7. Të merren masa nga komuna, për objektet që jepen me qira, të plotësojë më parë dokumentacionin e plotë tekniko ligjorë të konfirmuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë për pronësinë si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë, për vendimet e marra për njohje ose kthim prone, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” kreu II , pika 1/ ë.

Vazhdimisht

8. Të merren masa në bashkëpunim me Degën e Thesarit Sarandë për sistemimin e të ardhurave nga tarifat e konsumit të ujit të pishëm nga zëri “Sponsorizime” në zërin të “Të tjera të ardhura administrative”.

Menjëherë

9. Të merren masa për ngritjen e INU komunës dhe të ndërpritet praktika e kryerjes së funksioneve të INU nga nëpunës të zyrave të tjera.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141, 153 pika 1,2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë titullarit të institucionit që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore

“Vërejtje me shkrim”, për:

1. [redacted] me detyrë, përgjegjëse e Zyrës së Financës, për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 8 “Evidenca mbështetëse” germa c e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, në procedurat e prokurimeve publike.

2. [redacted] me detyrë, përgjegjës i administratës, për mos zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 355, datë 07.7.200 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrit të personelit”.

3. [redacted] me detyrë, inspektor për inventarizimin dhe administrimin e pronave të paluajtshme, për mos përgatitjen e plotë të dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim të komunës, për realizimin e funksioneve te ndryshme social ekonomike të komunitetit, për të bërë regjistrimin e pronave pranë ZVRPP Sarandë.

-Nuk ka kryer rakordim me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, për asetet në pronësi të Komunës. Nuk ka të dhëna të plota për trojet private dhe ato shtetërore, nuk ka bërë listimin e sipërfaqeve të trojeve private me analizë dhe atyre shtetërore.

Nuk janë kryer inventarizimet e plota për pronat në administrim të komunës dhe që shërbejnë për ushtrimin e funksioneve të ndryshme, si pronat e infrastrukturës, sheshe, rrugë , trotuare, lulishte, prona që përdoren në fushën e kullimit e të ujitjes, prona që

përdoren në fushën e bujqësisë , tokë bujqësore, prona që përdoren në fushën e ujësjellës kanalizimeve, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm etj. prona që përdoren për realizimin e funksioneve administrative, si zyrat etj.
Nuk është përgatitur dokumentacioni për regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin , në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", sipas pikës 9 10, 11, 13, 14 dhe pika 22, sipas trajtimit të bërë në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, pika 8/1.
4. [redacted] me detyrë, specialiste veterinere në Zyrën e Shërbimeve e cila mbulon edhe kontratat e qirave, për mos përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për dhënien me qira të pasurisë së Komunës dhe konkretisht nuk ka përgatitur dokumentacionin e mëposhtëm:
- Konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë për pronësinë shtetërore të Kullotave.
- Konfirmimin nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore" kreu II , pika 1/ ë, sipas trajtimit të bërë në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, pika 8/2.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma dhe Hekuarn Avdulaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT